

Kujdesi për Kujdesës në Haringej

Kujdesësit pa pagesë – Nevojat tuaja janë të rëndësishme

A jam unë kujdesës?

Kujdesës është dikush që kujdeset për apo mbështet një të afërm, partner, shok apo fqinj që është i ndikuar nga një paaftësi, apo sëmundje dhe nuk do të ishte në gjendje t'ia dilte mbanë në shtëpi pa ndihmë. Kujdesësi nuk paguhet.

Kujdesësit vijnë nga shumë rrethe të ndryshme shoqërore dhe komunitete. Kujdesësit mund të jenë të rinj apo të vjetër, meshkuj apo femra, të punësuar apo të papunë.

Ju nuk jeni vetëm

Nëse jeni kujdesës, nuk jeni vetëm. Një anketë e kohëve të fundit e udhëhequr nga Trusti Princess Royal për Kujdesës, shfaqti që tani janë shtatë milionë kujdesës në MB. Regjistrimi i përgjithshëm i vitit 2001 përafëron që ka përafërsisht 16000 kujdesës në Haringej.

Regjistrohu si Kujdesës

Si pjesë e dedikimit në vazhdim të Haringejit për të njohur dhe mbështetur kujdesësit, ju mund të regjistroheni si kujdesës me Shërbimet e Socialit. Kjo do të thotë që:

Ne do t'ju pyesim mbi pikëpamjet dhe mendimet rregullisht.

Ju mund të merrni pjesë në sesionet pa takim për t'u takuar me kujdesës të tjerë, për informata dhe këshilla, aktivitete suplementare dhe pushime të shkurta, për një trajtim të mirë, dhe për mundësi trajnimi si për shembull për zhvendosje dhe manovrim, vetëbesim, menaxhim stresi.

Ne do t'ju japim një kopje të broshurës së kujdesësve që ju jep informata të hollësishme mbi shërbimet dhe mbështetjen për kujdesësit dhe njerëzit për të cilët kujdesen në rreth.

Juve ju takon të keni vlerësim kujdesësish

Nëse ju jepni një nivel substancial të kujdesit për dikë në baza të rregullta, ju mund të kërkonit për një vlerësim të nevojave tuaj për vete, dhe kur të nevojitet, t'i keni shërbimet e dhëna direkt për ju.

Akti i ri i Kujdesësve

Akti i Kujdesësve (Shanset e Barabarta) 2004 synon që t'u japë kujdesësve më shumë zgjedhje dhe shanse më të mira. Këshilli duhet të bëjë çdo përpjekje për të siguruar që kujdesësit të mund të kenë akses të njëjtë shansesh – për të punuar, për t'u edukuar dhe trajnuar, për aktivitete të lira – që janë në dispozicion për ata që nuk kanë përgjegjësi kujdesi.

Si të kërkohet vlerësimi i kujdesësit

Nëse doni që të vlerësohen nevojat tuaja, thoni punonjësit të socialit, menaxherit të kujdesit apo koordinatorit të kujdesit të personit për të cilin kujdeseni. Ata do të mundësojnë një vlerësim për ju.

Nëse nuk jeni në kontakt me dikë nga Shërbimet Shëndetësore apo të Socialit, kontakto Ekipin e Mbështetjes së Kujdesësve në 020 8489 3967 të cilët do t'ju referojnë tek ekipi i përshtatshëm.

Për informata të mëtejme apo për këshilla kontakto:

Haringey Social Services
40 Cumberland Road
London N22 7SG

Tel: 020 8489 3967

Fax: 020 8489 3032

Email: carerssupportteam@haringey.gov.uk

grupet lokale mbështetëse

Në Haringej ka një numër organizatash që ofrojnë mbështetje dhe këshilla, me të cilat ju mund të lidheni direkt:

Qendra e Kujdesësve Haringej (*Haringey Carers Centre*)

Tel: 020 8489 8980

Informata, këshilla dhe mbështetje për kujdesës.

Shërbimi i Mbështetjes së Kujdesësve të Zinj dhe të Minoriteteve Etnike

(*Black and Minority Ethnic Carers Support Service*)

Tel: 020 8808 5510

Ofron shërbim kujdesi për fëmijë për të plotësuar nevojat e kujdesësve të zinj dhe të minoriteteve etnike në Haringej.

Shoqata e Mbështetjes së Kujdesësve të Shëndetit Mendor

(*Mental Health Carers Support Association*)

Tel: 020 8885 2006

Mbështetje për kujdesësit e njerëzve me sëmundje mendore.

Infermieret Admiral (*Admiral Nurses*)

Tel: 020 8442 6149

Mbështetje për kujdesësit e njerëzve të çmendur.

Shoqata e Alzheimer-it (*Alzheimer's Society*)

Tel: 020 8341 2045

Mbështetje për kujdesësit e njerëzve me sëmundjen e Alzheimer-it/çmendurinë.

Grupi i Mbështetjes së Kujdesësve Aziatikë (*Asian Carers Support Group*)

Tel: 020 8365 7708

Mbështetje për kujdesësit e njerëzve të të gjitha grupeve të kujdesit të origjinës Aziatike.

Nxirre Hapin Jashtë, Mencap (*Stepping Out, Mencap*)

Tel: 020 8365 0251

Mbështetje për kujdesësit e njerëzve me paaftësi në mësim.

Projekti i Kujdesësve të Rinj, Haringej (*Haringey Young Carers Project*)

Tel: 020 8348 4660

Mbështetje për kujdesësit nën 18 vjeç dhe familjet e tyre.

Ju lutem na thoni nëse e doni një kopje të kësaj fletushke në një nga formatet në vijim, dhe dërgoni formularin tek adresa e mëposhtme me Postim Falas.

Me Shkrim të Zmadhuar Në Disk Në audio kasetë Në Braille

Emri:

Adresa:

**Ju lutem kthejeni tek: Haringey Council, Translation and Interpreting Services
FREEPOST LONI8649, London N22 8BR**